



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 204

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 4 dhjetor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 285, datë 19.11.2024	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM) për mbikëqyrjen nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore pas lëshimit të certifikatave të vetme të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë dhe për kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë”..... 22095
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 974, datë 19.11.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 923, datë 6.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”..... 22116
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 975, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Lituanisë..... 22116
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 976, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Suedisë..... 22119
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 977, datë 19.11.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 39, datë 24.1.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Malit të Zi” dhe urdhrit nr. 525, datë 10.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”..... 22121
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 978, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Zvicrës..... 22122
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 979, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Greqisë..... 22123
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 980, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Danimarkës..... 22125

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 981, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	22127
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 982, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	22129
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 983, datë 19.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së aftës epizootike të shfaqur në shtetin e Turqisë.....	22129
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 986, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Bullgarisë.....	22131
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 987, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe dhive të shfaqur në shtetin e Greqisë.....	22132
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 988, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Francës.....	22134
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 989, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Italisë.....	22134
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 990, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë.....	22135
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 991, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	22136
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 992, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Austrisë.....	22137
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 993, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar.....	22138
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 994, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Austrisë.....	22140

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 995, datë 20.11.2024	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 370, datë 22.5.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës”, urdhrin nr. 369, datë 22.5.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kroacisë”, urdhrin nr. 490, datë 24.10.2022, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës” dhe urdhrin nr. 491, datë 24.10.2022, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Portugalisë”.....	22142
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 996, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Italisë.....	22142
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 997, datë 20.11.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Norvegjisë.....	22144
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 998, datë 20.11.2024	Për shfuqizimin e urdhrin nr. 873, datë 29.10.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Suedisë”, urdhrin nr. 580, datë 29.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Brazilit” dhe urdhrin nr. 583, datë 29.7.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Italisë”.....	22146
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1003, datë 25.11. 2024	Për miratimin e treguesve të harmonizuar të rrezikut.....	22147



URDHËR

Nr. 285, datë 19.11.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E METODAVE TË
PËRBASHKËTA TË SIGURISË (CSM)
PËR MBIKËQYRJEN NGA AUTORITETI
I SIGURISË HEKURUDHORE PAS
LËSHIMIT TË CERTIFIKATAVE TË
VETME TË SIGURISË DHE
AUTORIZIMEVE TË SIGURISË DHE
PËR KËRKESAT E SISTEMIT TË
MENAXHIMIT TË SIGURISË”¹**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, nenit 60, të ligjit nr. 142/2016, datë 22.12.2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e metodave të përbashkëta të sigurisë (CSM) për mbikëqyrjen nga autoriteti i sigurisë hekurudhore pas lëshimit të certifikatave të vetme të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë dhe për kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Autoriteti Rregullator Hekurudhor, administratorët e infrastrukturës dhe sipërmarrësit hekurudhorë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

¹ Kjo rregullore përaftron plotësisht me:

- Rregullore e Deleguar e Komisionit të (BE) 2018/761, e datës 16 shkurt 2018, “Vendosja e metodave të përbashkëta të sigurisë për mbikëqyrjen nga autoritetet kombëtare të sigurisë pas lëshimit të një certifikate të vetme sigurie, ose një autorizimi sigurie, në përputhje me direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”, dhe shfuqizimin e Rregullores së Komisionit (BE) nr. 1077/2012 (tekst me rëndësinë e ZEE), *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian* OJ L 129, 25.5.2018, f. 16–25.

- Rregullore e Deleguar e Komisionit të (BE) 2018/762, e datës 8 mars 2018, “Vendosja e metodave të përbashkëta të sigurisë për kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë, në përputhje me direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, dhe duke shfuqizuar rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1158/2010 dhe (BE) nr. 1169/2010 (tekst me rëndësinë e ZEE), *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian* OJ L 129 25.5.2018, f. 26.

² Kjo rregullore përaftron plotësisht me:

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E METODAVE TË
PËRBASHKËTA TË SIGURISË (CSM) PËR
MBIKËQYRJEN NGA AUTORITETI I
SIGURISË HEKURUDHORE PAS
LËSHIMIT TË CERTIFIKATAVE TË
VETME TË SIGURISË DHE
AUTORIZIMEVE TË SIGURISË DHE PËR
KËRKESAT E SISTEMIT TË MENAXHIMIT
TË SIGURISË²

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton:

1. Metodatat e përbashkëta të sigurisë (CSM), të referuara në pikën 1, të nenit 60, të ligjit nr. 142/2016, “Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë”, në vijim “Kodi”, për mbikëqyrjen e menaxhimit të sigurisë nga Autoriteti i Sigurisë Hekurudhore, në vijim “ASH”, të sipërmarrjeve hekurudhore, pasi iu është dhënë një certifikatë e vetme sigurie, dhe të administratorëve të infrastrukturës, pasi iu është dhënë një autorizim sigurie.

- Rregullore e Deleguar e Komisionit të (BE) 2018/761, e datës 16 shkurt 2018, “Vendosja e metodave të përbashkëta të sigurisë për mbikëqyrjen nga autoritetet kombëtare të sigurisë pas lëshimit të një certifikate të vetme sigurie, ose një autorizimi sigurie, në përputhje me direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”, dhe shfuqizimin e rregullores së Komisionit (BE) nr. 1077/2012 (tekst me rëndësinë e ZEE), *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian* OJ L 129, 25.5.2018, f. 16–25.

- Rregullore e Deleguar e Komisionit të (BE) 2018/762, e datës 8 mars 2018, “Vendosja e metodave të përbashkëta të sigurisë për kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë, në përputhje me direktivën (BE) 2016/798 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit”, dhe duke shfuqizuar rregulloret e Komisionit (BE) nr. 1158/2010 dhe (BE) nr. 1169/2010 (tekst me rëndësinë e ZEE), *Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian* OJ L 129 25.5.2018, f. 26.



2. Metodat e përbashkëta të sigurisë (CSM) për kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë, në lidhje me sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës, në përputhje me shkronjën “d”, pika 4, nenit 60, i Kodit.

3. Kjo rregullore zbatohet në lidhje me certifikatat e vetme të sigurisë dhe autorizimet e sigurisë të lëshuara në përputhje me Kodin.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “organ certifikimi i sigurisë” nënkupton organin përgjegjës për lëshimin e një certifikate të vetme sigurie, qoftë Agjencia Evropiane e Hekurudhave, në vijim “Agjencia”, ose “ASH”;

b) “shqetësim i mbetur” nënkupton një çështje të vogël të identifikuar gjatë vlerësimit të një kërkesë për një certifikatë të vetme sigurie ose për një autorizim sigurie, i cili nuk pengon lëshimin e tyre dhe mund të shtyhet për mbikëqyrje të mëvonshme.

Neni 3

Procesi i mbikëqyrjes

1. ASH-ja zbaton procesin e mbikëqyrjes të përcaktuar në aneksin I dhe vendos rregulla, ose procedura të brendshme për menaxhimin e procesit të mbikëqyrjes.

2. Për qëllime të mbikëqyrjes, ASH-ja pranon autorizimet, njohjet ose certifikatat e produkteve, ose shërbimeve të ofruara nga sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës, ose kontraktorët, partnerët ose furnizuesit e tyre, të dhëna në përputhje me ligjet në fuqi, si provë të aftësisë së sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës për të përmbushur kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 4

Teknikat për mbikëqyrje

ASH-ja miraton teknika të përshtatshme, të tilla si auditimet dhe inspektimet, dhe zgjedh ato më të përshtatshmet kur planifikon aktivitetin e mbikëqyrjes.

Neni 5

Lidhjet ndërmjet mbikëqyrjes dhe vlerësimit

1. ASH-ja që kryen mbikëqyrjen përdor dhe, kur është e nevojshme, ndan informacionin e mbledhur mbi performancën e sistemit të menaxhimit të sigurisë gjatë aktiviteteve të tij të mbikëqyrjes, me qëllim të rinovimit ose të përditësimit të certifikatave të vetme të sigurisë ose autorizimeve të sigurisë.

2. Në rastet kur ASH-ja i përmendur në paragrafin 1 nuk është përgjegjës për lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë, ai koordinon menjëherë me Agjencinë që vepron si organ certifikues i sigurisë, ose autoritetin kombëtar përkatës të sigurisë, në rastin e infrastrukturës ndërkufitare, me kërkesë të saj, pas marrjes së një kërkesë për rinovim ose përditësim.

3. Bazuar në rezultatin e koordinimit të përmendur në nënparagrafin e parë, ASH-ja identifikon dhe synon informacionin që është i rëndësishëm për të vlerësuar nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore, ose të administratorit të infrastrukturës funksionon efektivisht, duke përfshirë të paktën:

a) një përshkrim të mospërputhjeve kryesore, të cilat ndikojnë në performancën e sigurisë, ose krijojnë rreziqe serioze të sigurisë, dhe çdo fushë tjetër shqetësimi të identifikuar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes që nga vlerësimi i mëparshëm;

b) statusi i planit të veprimit (ose planeve) të krijuar nga sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës për zgjidhjen e mospërputhjeve kryesore dhe çdo fushë tjetër shqetësimi të përmendur në shkronjën “a” dhe veprimet përkatëse që janë ndërmarrë nga ASH-ja për të mbikëqyrë zgjidhjen e këtyre çështjeve;

c) një përmbledhje të performancës së sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të infrastrukturës;

ç) statusin e planit të veprimit (ose planeve) të krijuar nga sipërmarrja hekurudhore ose administratori i infrastrukturës të zgjidhë shqetësimet e mbetura nga vlerësimi i mëparshëm.



Neni 6

Kompetenca e personelit të përfshirë në mbikëqyrje

1. ASH-ja siguron që personeli i përfshirë në mbikëqyrje të ketë kompetencat e mëposhtme:

- a) njohja e kuadrit rregullator përkatës siç zbatohet për mbikëqyrjen;
- b) njohuri për funksionimin e sistemit hekurudhor;
- c) niveli i duhur i analizës kritike;
- ç) përvojë në mbikëqyrjen e një sistemi të menaxhimit të sigurisë ose të ngjashëm në sektorin hekurudhor, ose të një sistemi të menaxhimit të sigurisë në një sektor me sfida ekuivalente operationale dhe teknike;
- d) njohuri dhe përvojë në aftësitë e intervistimit;
- dh) zgjidhja e problemeve, komunikimi dhe puna në grup.

2. Në rastin e punës në grup, kompetencat mund të ndahen ndërmjet anëtarëve të ekipit.

3. Me synimin të sigurohet zbatimi i saktë të paragrafit 1, ASH-ja vendos një sistem të menaxhimit të kompetencave i cili të përfshijë:

- a) zhvillimin e profileve të kompetencave për çdo punë, pozicion ose rol;
- b) rekrutimi i personelit në përputhje me profilet e përcaktuara të kompetencave;
- c) mirëmbajtjen, zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencës së personelit, në përputhje me profilet e përcaktuara të kompetencave.

Neni 7

Kriteret e vendimmarrjes

1. ASH-ja vendos dhe publikon kriteret e vendimmarrjes se si vlerëson zbatimin e saktë të një sistemi të menaxhimit të sigurisë nga një sipërmarrje hekurudhore ose një administrator infrastrukture dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në kontrollin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me aktivitetet të sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të infrastrukturës.

Këto kriterë përfshijnë informacionin se si ASH-ja menaxhon dhe trajton mospërputhjet e identifikuara në sistemin e menaxhimit të sigurisë të sipërmarrjes hekurudhore dhe administratorit të infrastrukturës.

2. ASH-ja miraton dhe publikon një procedurë që detajon mënyrën se si sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe çdo palë tjetër e interesuar mund të paraqesin një ankesë për vendimet e marra gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes.

Neni 8

Koordinimi ndërmjet autoriteteve kombëtare të sigurisë dhe bashkëpunimi me autoritetet ose organet e tjera

1. ASH-ja i përfshirë në mbikëqyrjen e një administratori infrastrukture me infrastrukturë/a ndërkufitare ose të një sipërmarrjeje hekurudhore që operon në më shumë se një shtet, koordinon qasjen ndaj mbikëqyrjes në përputhje me nenin 70 të Kodit.

2. Pas dhënies së autorizimit të sigurisë ose certifikatës së vetme të sigurisë, ASH-ja në bashkëpunim me autoritetet kombëtare të sigurisë të shtetit/teve tjetër, vendosin menjëherë se cila prej tyre do të ketë një rol udhëheqës për koordinimin e mbikëqyrjes së zbatimit të saktë dhe efektivitetit të sistemit të menaxhimit të sigurisë, pa cenuar detyrimet e autoriteteve kombëtare të sigurisë sipas shkronjës “ç”, pika 2, neni 16, ligji nr. 88/2021, datë 1.7.2021, “Për krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore”, dhe të nenit 70 të Kodit.

3. Për qëllimet e paragrafit 1, ASH-ja zhvillon marrëveshje të bazuara në kuadrin për mbikëqyrjen e koordinuar dhe të përbashkët të përcaktuar në aneksin II.

4. ASH-ja zhvillon, gjithashtu, marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare, në vijim “autoriteti investigimit”, organet e certifikimit për subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe autoritetet ose organet e tjera kompetente.

Neni 9

Kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë në lidhje me sipërmarrjet hekurudhore

1. Sipërmarrjet hekurudhore vendosin sistemet e tyre të menaxhimit të sigurisë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën III.



2. Këto kërkesa të sistemit të menaxhimit të sigurisë zbatohen për certifikatat e vetme të sigurisë të përmendura në nenin 65 të Kodit, për qëllime të vlerësimit të aplikimeve dhe të mbikëqyrjes.

Neni 10

Kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë në lidhje me administratorët e infrastrukturës

1. Administratorët e infrastrukturës vendosin sistemet e tyre të menaxhimit të sigurisë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin IV.

2. Këto kërkesa të sistemit të menaxhimit të sigurisë zbatohen për autorizimet e sigurisë të përmendura në nenin 66 të Kodit, për qëllime të vlerësimit të aplikimeve dhe të mbikëqyrjes.

ANEKSI I

PROCESI I MBIKËQYRJES SIÇ PËRMENDET NË NENIN 3

1. E përgjithshme

ASH-ja zhvillon një proces të strukturuar dhe të auditueshëm për aktivitetin e plotë, i cili merr parasysh elementet e mëposhtme. Kjo siguron që procesi i mbikëqyrjes është përsëritës dhe merr parasysh nevojën për t'u përmirësuar vazhdimisht, siç tregohet në diagramin më poshtë në shtojcë.

2. Përgatitja e strategjisë dhe planit të mbikëqyrjes

ASH-ja:

a) mbledh dhe analizon të dhëna/informacione nga një sërë burimesh si input për strategjinë dhe planin ose planet. Burimet përfshijnë informacionin e mbledhur gjatë vlerësimit të sistemeve të menaxhimit të sigurisë, rezultatet e aktiviteteve të mëparshme të mbikëqyrjes, informacionin nga autorizimet e nënsistemeve ose mjeteve hekurudhore, raportet/rekomandimet e Autoritetin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare, raportet ose të dhënat e tjera të aksidenteve/incidenteve, sipërmarrjeve hekurudhore ose administratorëve të infrastrukturës, raportet vjetore të sigurisë për ASH-në, raportet vjetore të mirëmbajtjes nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen, ankesat

nga anëtarët e publikut dhe burime të tjera përkatëse;

b) identifikon në strategjinë e mbikëqyrjes fushat e rrezikut për aktivitetet e synuara të mbikëqyrjes, duke përfshirë ato që dalin nga integrimi dhe menaxhimi i faktorëve njerëzorë dhe organizativë, aty ku është e nevojshme;

c) zhvillon një plan ose plane mbikëqyrjeje që tregojnë se si do t'i japë efekt strategjisë së mbikëqyrjes gjatë ciklit jetësor të certifikatave të vetme të vlefshme të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë;

ç) prodhon një vlerësim fillestar të burimeve të nevojshme për t'i dhënë efekt planit ose planeve, bazuar në fushat e synuara të identifikuara;

d) ndan burime për t'i dhënë efekt planit ose planeve;

dh) adreson në strategjinë dhe planin/et e mbikëqyrjes çdo çështje që lidhet me operacionet ndërkufitare ose infrastrukturën/et përmes koordinimit me autoritet (ose autoritete) të tjera kombëtare të sigurisë.

3. Komunikimi i strategjisë dhe planit të mbikëqyrjes

ASH-ja:

a) u komunikon objektivat e përgjithshëm të strategjisë së mbikëqyrjes dhe shpjegimin e përgjithshëm të planit ose planeve sipërmarrjeve hekurudhore përkatëse ose administratorëve të infrastrukturës dhe, sipas rastit, më gjerësisht palëve të tjera të interesuara;

b) u jep sipërmarrjeve përkatëse hekurudhore ose administratorëve të infrastrukturës një shpjegim të përgjithshëm se si do të ndërmerret plani ose planet e mbikëqyrjes.

4. Zhvillimi i aktiviteteve të mbikëqyrjes

ASH-ja:

a) i jep efekt planit, ose planeve;

b) ndërmerr veprime proporcionale për të korrigjuar mangësitë e një sipërmarrjeje hekurudhore ose një administratori të infrastrukturës për të përmbushur detyrimet e saj ligjore, duke përfshirë lëshimin e çdo alarmi urgjent të sigurisë dhe zbatimin e masave të përkohshme të sigurisë kur është e nevojshme;

c) vlerëson se sa në mënyrë adekuate një sipërmarrje hekurudhore ose një administrator infrastrukture ka zhvilluar dhe ka zbatuar një plan veprimi ose plane për të korrigjuar çdo



mospërputhje ose shqetësim të mbetur brenda një periudhe kohore të caktuar;

ç) dokumenton rezultatet e aktiviteteve të tij mbikëqyrëse.

5. Rezultatet e aktiviteteve të mbikëqyrjes

ASH-ja:

a) ndan rezultatet e aktiviteteve të saj të mbikëqyrjes me sipërmarrjen përkatëse hekurudhore ose administratorin e infrastrukturës, duke përfshirë identifikimin e zonave të mospërputhjes nga ana e sipërmarrjes hekurudhore ose administratorit të infrastrukturës dhe çdo fushë të praktikës së mirë për të mbështetur përmirësimin e sigurisë;

b) mban një pasqyrë të performancës së sigurisë së sipërmarrjeve individuale hekurudhore ose administratorëve të infrastrukturës që operojnë në tregun hekurudhor;

c) publikon dhe u komunikon palëve përkatëse të interesuara pikëpamjet e tij mbi performancën e përgjithshme të sigurisë në sektorin hekurudhor;

ç) publikon dhe u komunikon palëve përkatëse të interesuara pikëpamjet e tij mbi efektivitetin e kuadrit rregullator të sigurisë;

d) përdor dhe kur është e nevojshme, ndan informacionin mbi performancën e sistemit të menaxhimit të sigurisë të mbledhur gjatë mbikëqyrjes së sipërmarrjeve hekurudhore ose administratorëve të infrastrukturës, përpara rivlerësimit të aplikacionit për një rinovim ose përditësim të certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë, me Agjencinë, duke vepruar si organ certifikues i sigurisë ose autoriteti përkatës kombëtar i sigurisë, në rastin e infrastrukturës ndërkufitare;

dh) aty ku është e përshtatshme, ndërmerret çdo veprim nëse ka një rast për kufizimin ose revokimin e certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë dhe në rastet kur nuk është përgjegjëse për lëshimin e certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë, informo autoritetin kompetent në përputhje me rrethanat.

6. Shqyrtimi i aktiviteteve të mbikëqyrjes

Në bazë të informacionit të mbledhur dhe të përvojës së fituar gjatë aktiviteteve të mbikëqyrjes dhe performancës së sigurisë, si në nivel individual, ashtu edhe në nivel të shtetit anëtar, ASH-ja në intervale të rregullta:

a) të kryejë një rishikim të strategjisë dhe planit/eve të mbikëqyrjes për të kontrolluar nëse

aktiviteti origjinal i synuar, përdorimi i të dhënave /informacioneve nga një shumëllojshmëri burimesh, rezultatet e mbikëqyrjes dhe shpërndarja e burimeve janë të përshtatshme, duke ndryshuar prioritetet sipas nevojës;

b) të rishikojë planin ose planet nëse është e nevojshme dhe të marrë parasysh ndikimin e ndryshimeve në strategjinë e mbikëqyrjes;

c) të kontribuojë kur është e nevojshme me pikëpamjet e tij dhe çdo propozim për të kapërcyer çdo mangësi në kuadrin rregullator të sigurisë.

Shtojca

Rezultatet e mbikëqyrjes

Zhvilloni dhe zbatoni planin/et e veprimit

Objektivat e përgjithshëm të strategjisë së mbikëqyrjes, shpjegimi i përgjithshëm i planit/eve të mbikëqyrjes dhe shpjegimi se si do të ndërmerren këto plane.

Performanca e përgjithshme e sigurisë në shtetin anëtar

Efektiviteti i kuadrit rregullator të sigurisë

Nr.

Po

Raportet e hetimit

Çdo informacion tjetër përkatës

Raportet vjetore të sigurisë nga sipërmarrjet hekurudhore dhe menaxherët e infrastrukturës

Rezultatet e mbikëqyrjes së mëparshme

Të dhënat e aksidentit/incidentit

Merrni veprime proporcionale

Vlerësoni rëndësinë dhe efektivitetin e planit/eve të veprimit

Masa e nevojshme?

Vlerësoni performancën e sigurisë

Dokumentoni rezultatet e mbikëqyrjes

Nr.

Zbatimi, promovimi dhe/ose zhvillimi i kuadrit rregullator të sigurisë

Po

Mospërputhje?

Informacioni përkatës i mbledhur mbi performancën e sistemit të menaxhimit të sigurisë

Jepni efekt planit/ve

Zhvilloni strategjinë dhe planin e mbikëqyrjes dhe koordinoni aktivitetet e mbikëqyrjes me autoritetet e tjera kombëtare të sigurisë

Rishikoni aktivitetet e mbikëqyrjes

Identifikoni zonat e rrezikut

Mblidhni dhe analizoni informacionin




Informacioni i mbledhur gjatë vlerësimit të sigurisë

Ndërmarrja hekurudhore ose menaxher i infrastrukturë

Autoriteti kombëtar i sigurisë që kryen mbikëqyrjen

Agjencia ose autoriteti përkatës kombëtar i sigurisë





ANEKSI II
KORNIZA PËR MBIKËQYRJEN E
KOORDINUAR DHE TË PËRBASHKËT SIÇ
PËRMENDET NË NENIN 8(2)

ASH-ja dhe autoritetet përkatëse kombëtare të sigurisë zhvillojnë rregullime të bazuara në parimet dhe elementet specifike të mëposhtme:

1. Bien dakord se cilat sipërmarrje hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës operojnë në atë mënyrë që të kërkojnë mbikëqyrje të koordinuar ose të përbashkët.

2. Bien dakord për gjuhën/t e përbashkëta dhe nivelin e konfidencialitetit të informacionit që do të përdoret për qëllimet e marrëveshjeve të tyre të koordinimit.

3. Bien dakord se çfarë informacioni të shkëmbejnë dhe një orar për shkëmbimin:

a) shkëmbejnë informacionin përkatës për sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës të identifikuar në pikën 1 dhe ndajnë rezultatet nga aktivitetet e tyre të vlerësimit;

b) sigurojnë kopje të autorizimeve të sigurisë kur është e përshtatshme;

c) ndajnë rezultatet nga aktivitetet e ndërlidhura të mbikëqyrjes, duke përfshirë vendimet dhe veprimet përmbartimore, aty ku është e nevojshme;

ç) ndajnë informacion mbi performancën e sigurisë së sipërmarrjeve hekurudhore dhe administratorëve të infrastrukturës të identifikuar në pikën 1.

4. Ndajnë kriteret e vendimmarrjes, për:

a) ndarjen e informacionit se si çdo autoritet kombëtar i sigurisë synon aktivitetet e tij për çdo sipërmarrje hekurudhore dhe administrator të infrastrukturës në fjalë, si pjesë e planit të mbikëqyrjes;

b) vendosjen e një dialogu midis autoriteteve përkatëse kombëtare të sigurisë për përgjigjen e propozuar për trajtimin e boshllëqeve të mëdha të pajtueshmërisë.

5. Menaxhojnë koordinimin:

a) ndajnë strategjitë dhe planet ekzistuese të mbikëqyrjes;

b) të vendosin pika të përbashkëta interesi dhe/ose çështje të përbashkëta;

c) të planifikojnë me efikasitet iniciativa individuale, të koordinuara ose të përbashkëta, pa shkaktuar shqetësime të panevojshme për sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e

infrastrukturës dhe duke shmangur mbivendosjet në fushën e këtyre nismave.

6. Bien dakord, se cilat autoritete (ose autoritete) kombëtare të sigurisë duhet të ndjekin veprimet që synojnë të adresojnë shqetësimet e mbetura që janë shtyrë për mbikëqyrje, aty ku është e përshtatshme.

7. Bien dakord se cilat fusha të synoni në mënyrë të koordinuar ose të përbashkët të:

a) identifikojnë rreziqet kryesore për sipërmarrjet përkatëse hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës që duhet të adresohen në mënyrë të koordinuar ose të përbashkët nga autoritetet kombëtare të sigurisë;

b) bien dakord se cili autoritet kombëtar i sigurisë do të udhëheqë aktivitetet për çfarë çështjesh, kur është e nevojshme, në bazë të kriterëve të përcaktuara mirë;

c) bien dakord se cilat lloje të aktiviteteve të përbashkëta të mbikëqyrjes duhet të ndërmerren, aty ku është e nevojshme;

ç) bien dakord se si sipërmarrjet hekurudhore dhe administratorët e infrastrukturës duhet të ndërgjegjësohen për marrëveshjet dhe marrëveshjet që po arrijnë autoritetet kombëtare të sigurisë.

8. Ndajnë praktikën e mirë:

a) të zhvillojnë marrëveshje për të rishikuar dhe për të koordinuar në baza të rregullta aktivitetet e mbikëqyrjes për sipërmarrjet hekurudhore përkatëse dhe administratorët e infrastrukturës;

b) të zhvillojnë marrëveshje për të vlerësuar efektivitetin e koordinimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kombëtare të sigurisë, duke përfshirë Agjencinë sipas rastit.

ANEKSI III
KËRKESAT E SISTEMIT TË MENAXHIMIT
TË SIGURISË NË LIDHJE ME
SIPËRMARRJET HEKURUDHORE

1. Konteksti i sipërmarrjes hekurudhore

1.1. Sipërmarrja hekurudhore:

a) përshkruan llojin, shtrirjen dhe fushën e funksionimit të tij;

b) identifikon rreziqet serioze për sigurinë që paraqesin operacionet hekurudhore nëse ato kryhen nga vetë subjekti, ose nga kontraktorët, partnerët ose furnizuesit nën kontrollin e saj;

c) identifikon palët e interesuara (p.sh., autoritetin rregullator, autoritetet e sigurisë, administratorët e infrastrukturës, kontraktorët,



furnizuesit, partnerët), duke përfshirë ato palë të jashtme në sistemin hekurudhor, që janë të rëndësishme për sistemin e menaxhimit të sigurisë;

ç) identifikon dhe mban kërkesat ligjore dhe të tjera në lidhje me sigurinë nga palët e interesuara të përmendura në shkronjën “c”;

d) të sigurojë që kërkesat e përmendura në shkronjën “ç” të merren parasysh në zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë;

dh) të përshkruajë objektin e sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke treguar se cila pjesë e biznesit është e përfshirë ose jo në objektin e tij dhe duke marrë parasysh kërkesat e përmendura në shkronjën “ç”.

2. Drejtimi

2.1. Drejtuesi i lartë dhe përkushtimi

2.1.1. Drejtuesi i lartë demonstroi nivel të lartë dhe përkushtim për zhvillimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë duke bërë:

a) marrjen e përgjegjësisë së përgjithshme për sigurinë;

b) sigurimin e përkushtimit ndaj sigurisë nga drejtuesi në nivele të ndryshme, brenda sipërmarrjeve hekurudhore nëpërmjet aktiviteteve të tyre dhe në marrëdhëniet e tyre me stafin dhe kontraktorët;

c) sigurimin që politika e sigurisë dhe objektivat e sigurisë janë krijuar, kuptuar dhe janë në përputhje me drejtimin strategjik të sipërmarrjes hekurudhore;

ç) sigurimin e integritetit të kërkesave të sistemit të menaxhimit të sigurisë në proceset e biznesit të sipërmarrjes hekurudhore;

d) sigurimin që burimet e nevojshme për sistemin e menaxhimit të sigurisë janë të disponueshme;

dh) sigurimin që sistemi i menaxhimit të sigurisë të jetë efektiv në kontrollin e rreziqeve të sigurisë të paraqitura nga subjekti;

e) inkurajimin e stafit për të mbështetur pajtueshmërinë me kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë;

ë) promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë;

f) që siguria merret parasysh kur identifikohen dhe menaxhohen rreziqet e biznesit të sipërmarrjes hekurudhore dhe shpjegohet se si do të njihet dhe zgjidhet konflikti midis sigurisë dhe qëllimeve të tjera të biznesit;

g) promovimin e një kulture pozitive sigurie.

2.2. Politika e sigurisë

2.2.1. Një dokument që përshkruan politikën e sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore është krijuar nga drejtuesi i lartë dhe është:

a) i përshtatshëm për llojin dhe shtrirjen e operacioneve hekurudhore të sipërmarrjeve hekurudhore;

b) miratuar nga shefi ekzekutiv i sipërmarrjes hekurudhore (ose një përfaqësues/ët) e drejtuesit të lartë;

c) zbatuar në mënyrë aktive, komunikuar dhe vënë në dispozicion të gjithë stafit.

2.2.2. Politika e hartuar e sigurisë:

a) përfshin një angazhim për të përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe të tjera që lidhen me sigurinë;

b) siguron një kornizë për vendosjen e objektivave të sigurisë dhe vlerësimin e performancës së sigurisë së sipërmarrjeve hekurudhore kundrejt këtyre objektivave;

c) përfshin një angazhim për të kontrolluar rreziqet e sigurisë që lindin si nga aktivitetet e tij, ashtu edhe nga ato të shkaktuara nga të tjerët;

ç) përfshin një angazhim për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë;

d) mban në përputhje me strategjinë e biznesit dhe vlerësimin e performancës së sigurisë të sipërmarrjes hekurudhore.

2.3. Rolet organizative, aftësitë, përgjegjësitë dhe autoritetet

2.3.1. Aftësitë, përgjegjësitë dhe autoritetet e personelit që ka një rol që ndikon në sigurinë (përfshirë drejtuesin dhe stafin tjetër të përfshirë në detyrat e lidhura me sigurinë) përcaktohen në të gjitha nivelet brenda sipërmarrjes hekurudhore, dokumentohen, caktohen dhe u komunikohen atyre.

2.3.2. Subjekti të sigurojë që personeli me përgjegjësi të deleguara për detyrat e lidhura me sigurinë të ketë autoritetin, kompetencën dhe burimet e duhura për të kryer detyrat e tyre pa u ndikuar negativisht nga aktivitetet e funksioneve të tjera të biznesit.

2.3.3. Delegimi i përgjegjësisë për detyrat e lidhura me sigurinë dokumentohen dhe i komunikohen personelit përkatës, pranohen dhe kuptohen.

2.3.4. Subjekti përshkruan ndarjen e roleve të përmendura në paragrafin 2.3.1. për funksionet e biznesit brenda dhe aty ku është e rëndësishme,



jashtë sipërmarrjes hekurudhore (shih 5.3, “Kontraktorët, partnerët dhe furnitorët”).

2.4. Konsultimi i stafit dhe i palëve të tjera

2.4.1. Stafi, përfaqësuesit e tyre dhe palët e jashtme të interesuara, sipas rastit dhe sipas rastit, do të konsultohen për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në pjesët përkatëse për të cilat ata janë përgjegjës, duke përfshirë aspektet e sigurisë të procedurave operacionale.

2.4.2. Subjekti do të lehtësojë konsultimin me personelin duke ofruar metoda dhe mjete për përfshirjen e stafit, regjistrimin e opinionit të personelit dhe ofrimin e komenteve mbi opinionin e personelit.

3. Planifikimi

3.1. Veprimet për të adresuar rreziqet

3.1.1. Vlerësimi i rrezikut

3.1.1.1. Subjekti:

a) identifikon dhe analizon të gjitha rreziqet operacionale, organizative dhe teknike që lidhen me llojin, shtrirjen dhe fushën e operacioneve të kryera nga subjekti. Rreziqe të tilla përfshijnë ato që rrjedhin nga faktorë njerëzorë dhe organizativë, si ngarkesa e punës, përshtatshmëria e punës, lodhja ose përshtatshmëria e procedurave dhe aktivitetet e palëve të tjera të interesuara (shih 1, “Konteksti i sipërmarrjeve hekurudhore”);

b) vlerëson rreziqet e përmendura në shkronjën “a”, duke aplikuar metodat e duhura të vlerësimit të rrezikut;

c) zhvillon dhe vendos masa sigurie, me identifikimin e përgjegjësive të ndërlidhura (shih 2.3, “Rolet organizative, aftësitë, përgjegjësitë dhe autoritetet”);

ç) zhvillon një sistem për monitorimin e efektivitetit të masave të sigurisë (shih 6.1, “Monitorimi”);

d) njeq nevojën për të bashkëpunuar me palët e tjera të interesuara (si sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës, prodhuesit, furnizuesit të materialeve të mirëmbajtjes, subjektit përgjegjës për mirëmbajtjen, mbajtësit e automjeteve hekurudhore, ofruesit e shërbimit dhe entin e prokurimit), sipas rastit, për rreziqet e përbashkëta dhe vënien në vend të masave adekuate të sigurisë;

dh) komunikon rreziqet stafit dhe palëve të jashtme të përfshira (shih 4.4, “Informacioni dhe komunikimi”).

3.1.1.2. Gjatë vlerësimit të rrezikut, një subjekt merr parasysh nevojën për të përcaktuar, siguruar dhe mbajtur një mjedis të sigurt pune që është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3.1.2. Planifikimi për ndryshim

3.1.2.1. Subjekti identifikon rreziqet e mundshme të sigurisë dhe masat e duhura të sigurisë (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”) përpara zbatimit të një ndryshimi (shih 5.4 “Menaxhimi i ndryshimit”) në përputhje me procesin e menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë marrjen në konsideratë të rreziqeve të sigurisë nga vetë procesi i ndryshimit.

3.2. Objektivat dhe planifikimi i sigurisë

3.2.1. Subjekti përcakton objektivat e sigurisë për funksionet përkatëse në nivelet përkatëse për të ruajtur dhe, kur është praktikisht e arsyeshme, për të përmirësuar performancën e saj të sigurisë.

3.2.2. Objektivat e sigurisë hartohen në mënyrë që:

a) të jenë në përputhje me politikën e sigurisë dhe objektivat strategjikë të sipërmarrjes hekurudhore (aty ku është e aplikueshme);

b) të jenë të lidhura me rreziqet prioritare që ndikojnë në performancën e sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore;

c) të jenë të matshme;

ç) të marrin parasysh kërkesat ligjore dhe të tjera në fuqi;

d) të rishikohen në lidhje me arritjet e tyre dhe të rishikohen sipas nevojës;

dh) të komunikohen.

3.2.3. Subjekti harton plane për të arritur objektivat e saj të sigurisë.

3.2.4. Subjekti përshkruajë strategjinë dhe planin/et e përdorur/a për të monitoruar arritjen e objektivave të sigurisë (shih 6.1, “Monitorimi”).

4. Mbështetje

4.1. Burimet

4.1.1. Subjekti siguron burimet, duke përfshirë stafin kompetent dhe pajisjet efektive dhe të përdorshme, të nevojshme për ngritjen, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë.

4.2. Kompetenca

4.2.1. Sistemi i menaxhimit të kompetencave të sipërmarrjes hekurudhore duhet të sigurojë që personeli që ka një rol që ndikon në sigurinë është kompetent në detyrat e lidhura me sigurinë për të cilat ata janë përgjegjës (shih 2.3, “Rolet



organizative, aftësitë, përgjegjësitë dhe autoritetet”), duke përfshirë të paktën:

a) identifikimi i kompetencave (përfshirë njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe qëndrimet joteknike) të nevojshme për detyrat që lidhen me sigurinë;

b) parimet e përzgjedhjes (niveli bazë arsimor, aftësia psikologjike dhe fizike e nevojshme);

c) trajnimin fillestar, përvojën dhe kualifikimin;

ç) trajnimi i vazhdueshëm dhe përditësimi periodik i kompetencave ekzistuese;

d) vlerësimi periodik i kompetencës dhe kontrollët e aftësisë psikologjike dhe fizike për të siguruar që kualifikimet dhe aftësitë mbahen me kalimin e kohës;

dh) trajnime specifike në pjesët përkatëse të sistemit të menaxhimit të sigurisë, në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre të lidhura me sigurinë.

4.2.2. Subjekti siguron një program trajnimi, siç përmendet në shkronjat “c”, “ç” dhe “dh” të paragrafit 4.2.1, për personelin që kryen detyra të lidhura me sigurinë, i cili siguron që:

a) programi i trajnimit ofrohet sipas kërkesave të identifikuar të kompetencave dhe të nevojave individuale të personelit;

b) aty ku është e aplikueshme, trajnimi siguron që stafi mund të operojë në të gjitha kushtet e funksionimit (normale, të degraduara dhe emergjente);

c) kohëzgjatja e trajnimit dhe frekuenca e trajnimit rifreskues janë të përshtatshme për objektivat e trajnimit;

ç) mbahen shënime për të gjithë stafin (shih 4.5.3, “Kontrolli i informacionit të dokumentuar”);

d) programi i trajnimit rishikohet dhe auditohet rregullisht (shih 6.2, “Auditimi i brendshëm”) dhe bëhen ndryshime kur është e nevojshme (shih 5.4, “Menaxhimi i ndryshimit”).

4.2.3. Marrëveshjet e kthimit në punë duhet të jenë të vendosura për personelin pas aksidenteve/incidenteve ose mungesave të gjata nga puna, duke përfshirë ofrimin e trajnimeve shtesë kur identifikohet një nevojë e tillë.

4.3. Ndërgjegjësimi

4.3.1. Drejtuesi i lartë siguron që stafi që ka një rol që ndikon në sigurinë të jenë të vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojat e aktiviteteve të tyre dhe se si ato kontribuojnë në zbatimin e saktë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë arrijtjen e objektivave të sigurisë (shih 3.2, “Objektivat dhe planifikimi i sigurisë”).

4.4. Informacioni dhe komunikimi

4.4.1. Subjekti përcakton kanalet e duhura të komunikimit për të siguruar që informacioni në lidhje me sigurinë të shkëmbehet ndërmjet niveleve të ndryshme të sipërmarrjes hekurudhore dhe me palët e jashtme të interesuara, duke përfshirë kontraktorët, partnerët dhe furnizuesit.

4.4.2. Për të siguruar që informacioni i lidhur me sigurinë të arrijë tek ata që marrin gjykime dhe vendime, subjekti duhet të menaxhojë identifikimin, marrjen, përpunimin, gjenerimin dhe shpërndarjen e informacionit të lidhur me sigurinë.

4.4.3. Subjekti siguron që informacioni i lidhur me sigurinë është:

a) relevant, i plotë dhe i kuptueshëm për përdoruesit e synuar;

b) i vlefshëm;

c) i saktë;

ç) i vijueshëm;

d) i kontrolluar (shih 4.5.3, “Kontrolli i informacionit të dokumentuar”);

dh) i komunikuar përpara se të hyjë në fuqi;

e) i marrë dhe i kuptuar.

4.5. Informacioni i dokumentuar

4.5.1. Dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të sigurisë

4.5.1.1. Ekziston një përshkrim i sistemit të menaxhimit të sigurisë duke përfshirë:

a) identifikimin dhe përshkrimin e proceseve dhe aktiviteteve që lidhen me sigurinë e operacioneve hekurudhore, duke përfshirë detyrat e lidhura me sigurinë dhe përgjegjësitë e ndërlidhura (shih 2.3, “Rolet organizative, përgjegjësitë, përgjegjësitë dhe autoritetet”);

b) ndërveprimin e këtyre proceseve;

c) procedurat ose dokumentet e tjera që përshkruajnë se si zbatohen këto procese;

ç) identifikimin e kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve me një përshkrim të llojit dhe shtrirjes së shërbimeve të ofruara;

d) identifikimin e marrëveshjeve kontraktuale dhe marrëveshjeve të tjera të biznesit, të lidhura ndërmjet sipërmarrjes hekurudhore dhe palëve të tjera të identifikuar nën “d”, të nevojshme për të kontrolluar rreziqet e sigurisë të sipërmarrjes hekurudhore dhe ato që lidhen me përdorimin e kontraktorëve;

dh) referencë për informacionin e dokumentuar të kërkuar nga kjo rregullore.



4.5.1.2. Subjekti dorëzon një raport vjetor të sigurisë ASH-ja, në përputhje me pikën 7, neni 64 të Kodit, duke përfshirë:

a) një sintezë të vendimeve mbi nivelin e rëndësisë së ndryshimeve të lidhura me sigurinë, duke përfshirë një pasqyrë të ndryshimeve të rëndësishme;

b) objektivat e sigurisë të sipërmarrjes hekurudhore për vitin/ët e ardhshëm dhe si ndikojnë rreziqet serioze për sigurinë në vendosjen e këtyre objektivave të sigurisë;

c) rezultatet e investigimit të brendshëm të aksidenteve/incidenteve (shih 7.1, “Mësimi nga aksidentet dhe incidentet”) dhe aktivitetet e tjera monitoruese (shih 6.1, “Monitorimi”, 6.2, “Auditimi i brendshëm”, dhe 6.3, “Rishikimi i drejtuesit”), në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të urdhrit nr. 170, datë 13.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Mbi një metodë të përbashkët sigurie për monitorimin që zbatohet nga sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës dhe nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen pas marrjes së certifikatës së vetme të sigurisë ose autorizimit të sigurisë”;

ç) detajet e progresit në adresimin e rekomandimeve të pazgjidhura nga autoriteti i investigimit (shih 7.1, “Mësimi nga aksidentet dhe incidentet”);

d) treguesit e sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore të përcaktuara për të vlerësuar performancën e sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore (shih 6.1, “Monitorimi”);

dh) aty ku është e aplikueshme, konkluzionet e raportit vjetor të këshilltarit të sigurisë, mbi aktivitetet e sipërmarrjes hekurudhore në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme.

4.5.2. Krijimi dhe përditësimi

4.5.2.1. Subjekti duhet të sigurojë që gjatë krijimit dhe përditësimit të informacionit të dokumentuar, në lidhje me sistemin e menaxhimit të sigurisë të përdoren formatet dhe mediat adekuate.

4.5.3. Kontrolli i informacionit të dokumentuar

4.5.3.1. Subjekti duhet të kontrollojë informacionin e dokumentuar në lidhje me sistemin e menaxhimit të sigurisë, në veçanti ruajtjen, shpërndarjen dhe kontrollin e ndryshimeve, për të siguruar disponueshmërinë, përshtatshmërinë dhe mbrojtjen e tij aty ku është e nevojshme.

4.6. Integrimi i faktorëve njerëzorë dhe organizativë

4.6.1. Subjekti duhet të demonstrojë një qasje sistematike për integrimin e faktorëve njerëzorë dhe

organizativë brenda sistemit të menaxhimit të sigurisë. Kjo qasje do të:

a) përfshijë zhvillimin e një strategjie dhe përdorimin e ekspertizës dhe metodave të njohura nga fusha e faktorëve njerëzorë dhe organizativë;

b) adresojë rreziqet që lidhen me projektimin dhe përdorimin e pajisjeve, detyrat, kushtet e punës dhe rregullimet organizative, duke marrë parasysh aftësitë njerëzore, si dhe kufizimet, dhe ndikimet në performancën njerëzore.

5. Operimi

5.1. Planifikimi dhe kontrolli operacional

5.1.1. Gjatë planifikimit, zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit të proceseve të saj operacionale, subjekti siguron që gjatë operimit:

a) zbatohen kriteret e pranimit të rrezikut dhe masat e sigurisë (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”);

b) janë dorëzuar planet për të arritur objektivat e sigurisë (shih 3.2, “Objektivat dhe planifikimi i sigurisë”);

c) informacioni mbledhet për të matur zbatimin e saktë dhe efektivitetin e aranzhimeve operacionale (shih 6.1, “Monitorimi”).

5.1.2. Subjekti siguron që marrëveshjet e saj operacionale janë në përputhje me kërkesat e lidhura me sigurinë e specifikimeve teknike të zbatueshme për ndërveprueshmërinë dhe rregullat përkatëse kombëtare dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse (shih 1, “Konteksti i sipërmarrjes hekurudhore”).

5.1.3. Për të kontrolluar rreziqet aty ku është e rëndësishme për sigurinë e aktiviteteve operacionale (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”), merren parasysh të paktën sa vijon:

a) planifikimi i linjave ekzistuese ose të reja të trenave dhe shërbimeve të reja të trenave, duke përfshirë futjen e llojeve të reja të mjeteve hekurudhore, nevojën për marrjen me qira të mjeteve dhe/ose punësimin e personelit nga palët e jashtme dhe shkëmbimin e informacionit mbi mirëmbajtjen për qëllime operacionale me subjektet përgjegjëse të mirëmbajtjes;

b) zhvillimi dhe zbatimi i orarit të trenave;

c) përgatitja e trenave ose mjeteve përpara lëvizjes, duke përfshirë kontrollet para nisjes dhe përbërjen e trenit;

ç) drejtimin e trenave ose lëvizjen e mjeteve në kushte të ndryshme funksionimi (normale, të degraduara dhe emergjente);

d) përshtatjen e operimit me kërkesat për largim nga funksionimi dhe njoftimin e kthimit në



funksionim të lëshuara nga subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen;

dh) autorizimet për lëvizjen e automjeteve;

e) përdorshmëria e ndërfaqeve në kabinat e drejtimit të trenave dhe qendrat e kontrollit të trenave dhe me pajisjet e përdorura nga personeli i mirëmbajtjes.

5.1.4. Për të kontrolluar shpërndarjen e përgjegjësi aty ku është e rëndësishme për sigurinë e aktiviteteve operacionale, subjekti identifikon përgjegjësitë për koordinimin dhe për menaxhimin e drejtimit të sigurt të trenave dhe lëvizjeve të mjeteve dhe të përcaktojë se si detyrat përkatëse që ndikojnë në ofrimin e sigurt të të gjitha shërbimeve i ndahen personelit kompetent brenda sipërmarrjes hekurudhore (shih 2.3, “Rolet organizative, aftësitë, përgjegjësitë dhe autoritetet”) dhe palëve të tjera të jashtme të kualifikuara kur është e përshtatshme (shih 5.3, “Kontraktorët, partnerët dhe furnizuesit”).

5.1.5. Për të kontrolluar informacionin dhe komunikimin aty ku është e rëndësishme për sigurinë e aktiviteteve operacionale (shih 4.4, “Informacioni dhe komunikimi”), stafi përkatës (p.sh., ekuipazhet e trenave) këshillohen për detajet e çdo kushti të specifikuar të udhëtimit, duke përfshirë ndryshimet përkatëse që mund të rezultojnë në rrezik, kufizime të përkohshme ose të përhershme operacionale (p.sh., për shkak të llojit specifik të mjeteve ose rrugëve specifike) dhe kushteve për dërgesat e jashtëzakonshme, aty ku zbatohet.

5.1.6. Për të kontrolluar kompetencën aty ku është e rëndësishme për sigurinë e aktiviteteve operacionale (shih 4.2, “Kompetenca”), subjekti siguron, në përputhje me legjislacionin në fuqi (shih 1, “Konteksti i sipërmarrjes hekurudhore”), për stafin e saj:

a) pajtueshmërinë me udhëzimet e tyre të trajnimit dhe të punës, dhe aty ku kërkohet ndërmerren veprimet korrigjuese;

b) trajnime specifike në rast të ndryshimeve të parashikuara që ndikojnë në drejtimin e operacioneve ose caktimin e detyrave të tyre;

c) miratimi i masave adekuate pas aksidenteve dhe incidenteve.

5.2. Menaxhimi i aseteve

5.2.1. Subjekti duhet të menaxhojë rreziqet e sigurisë që lidhen me asetet fizike gjatë gjithë ciklit të tyre jetësor (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”), nga projektimi deri tek asgjësimi, dhe të përmbushë

kërkesat e faktorëve njerëzorë në të gjitha fazat e ciklit jetësor.

5.2.2. Subjekti:

a) të sigurojë që asetet të përdoren për qëllimin e synuar, duke ruajtur gjendjen e tyre të sigurt operacionale, në përputhje me pikën 2, neni 137, të Kodit, aty ku është e përshtatshme, dhe nivelin e tyre të pritshëm të performancës;

b) të menaxhojë asetet në funksione normale dhe të degraduara;

c) të zbulojë sa më shpejt të jetë e mundur raste të mospërputhjes me kërkesat e funksionimit përpara ose gjatë funksionimit të aktivitetit, duke përfshirë zbatimin e kufizimeve të përdorimit sipas rastit për të siguruar një gjendje të sigurt funksionimi të aktivitetit (shih 6.1, “Monitorimi”).

5.2.3. Subjekti siguron që aranzhimet e saj të menaxhimit të aseteve, aty ku është e aplikueshme, të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat thelbësore të përcaktuara në Specifikimet Teknike përkatëse për Ndërveprueshmërinë dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse (shih 1, “Konteksti i sipërmarrjes hekurudhore”).

5.2.4. Për të kontrolluar rreziqet kur është e rëndësishme për furnizimin e mirëmbajtjes (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”), duhet të merren parasysh të paktën sa vijon:

a) identifikimin e nevojës për mirëmbajtje për të mbajtur aktivin në një gjendje të sigurt funksionale, bazuar në përdorimin e planifikuar dhe real të aktivitetit dhe karakteristikat e tij të projektimit;

b) menaxhimin e largimit të aktivitetit nga operimi për mirëmbajtje, kur janë identifikuar defekte ose kur gjendja e asetit degradon jashtë kufijve të një gjendjeje të sigurt operative, siç përmendet në pikën “a”;

c) menaxhimin e kthimit në funksionim të asetit me kufizime eventuale të përdorimit pas dorëzimit të mirëmbajtjes për të siguruar që ai është në një gjendje të sigurt funksionale;

ç) menaxhimin e pajisjeve të monitorimit dhe të matjes për të siguruar që ato janë të përshtatshme për qëllimin e synuar.

5.2.5. Për të kontrolluar informacionin dhe komunikimin aty ku është e rëndësishme për menaxhimin e sigurt të aseteve (shih 4.4, “Informacioni dhe komunikimi”), subjekti duhet të marrë parasysh:

a) shkëmbimin e informacionit përkatës brenda sipërmarrjes hekurudhore ose me entitete të jashtme



përgjegjëse për mirëmbajtjen (shih 5.3, “Kontraktorët, partnerët dhe furnitorët”), veçanërisht për keqfunksionimet, aksidentet, incidentet e lidhura me sigurinë si dhe për kufizimet eventuale të përdorimit të aktivitetit;

b) gjurmueshmërinë e të gjithë informacionit të nevojshëm, duke përfshirë informacionin në lidhje me pikën “a” (shih 4.4, “Informacioni dhe komunikimi”), dhe 4.5.3, “Kontrolli i informacionit të dokumentuar”);

c) krijimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave, duke përfshirë menaxhimin e ndryshimeve që ndikojnë në sigurinë e aseteve (shih 5.4, “Menaxhimi i ndryshimit”).

5.3. Kontraktorët, partnerët dhe furnitorët

5.3.1. Subjekti duhet të identifikojë dhe kontrollojë rreziqet e sigurisë që rrjedhin nga aktivitetet e jashtme, duke përfshirë operacionet ose bashkëpunimin me kontraktorët, partnerët dhe furnitorët.

5.3.2. Për të kontrolluar rreziqet e sigurisë të përmendura në paragrafin 5.3.1, subjekti përcakton kriteret për përzgjedhjen e kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve dhe kërkesat e kontratës që ata duhet të përmbushin, duke përfshirë:

a) kërkesat ligjore dhe të tjera në lidhje me sigurinë (shih 1, “Konteksti i sipërmarrjes hekurudhore”);

b) nivelin e kompetencës që kërkohet për të kryer detyrat e përcaktuara në kontratë (shih 4.2, “Kompetenca”);

c) përgjegjësitë për detyrat që do të kryhen;

ç) performanca e pritshme e sigurisë që do të ruhet gjatë kontratës;

d) detyrimet në lidhje me shkëmbimin e informacionit të lidhur me sigurinë (shih 4.4, “Informacioni dhe komunikimi”);

dh) gjurmueshmëria e dokumenteve të lidhura me sigurinë (shih 4.5, “Informacioni i dokumentuar”).

5.3.3. Në përputhje me procesin e përcaktuar në nenin 7, të urdhrin nr. 170, datë 13.12.2023, më sipër, subjekti monitoron:

a) performancën e sigurisë së të gjitha aktiviteteve dhe operacioneve të kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve për të siguruar që ata të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratë;

b) ndërgjegjësimin e kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve për rreziqet e sigurisë që ato sjellin në operacionet e sipërmarrjes hekurudhore.

5.4. Menaxhimi i ndryshimit

5.4.1. Subjekti zbaton dhe kontrollon ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë për të ruajtur ose përmirësuar performancën e sigurisë. Kjo përfshin vendimet në faza të ndryshme të menaxhimit të ndryshimit dhe rishikimin pasues të rreziqeve të sigurisë (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”).

5.5. Menaxhimi i urgjencës

5.5.1. Subjekti identifikon situatat emergjente dhe masat shoqëruese që duhen marrë në kohë për menaxhimin e këtyre situatave (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”) për të rivendosur kushtet normale të funksionimit.

5.5.2. Subjekti siguron që, për çdo lloj urgjence të identifikuar:

a) të kontaktohen menjëherë shërbimet e urgjencës;

b) shërbimeve të urgjencës u jepen të gjitha informacionet përkatëse për të përgatitur reagimin e tyre emergjent;

c) ofron menjëherë ndihmën e parë.

5.5.3. Subjekti identifikon dhe dokumenton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve.

5.5.4. Subjekti harton plane për veprim, alarme dhe informacione në rast emergjence, duke përfshirë marrëveshjet, për:

a) lajmërimin e të gjithë stafit me përgjegjësi për menaxhimin e emergjencës;

b) komunikimin e informacionit të gjitha palëve (p.sh., administratorin e infrastrukturës, kontraktorët, autoritetet, shërbimet e urgjencës), duke përfshirë udhëzimet emergjente për udhëtarët;

c) marrjen e çdo vendimi të kërkuar në përputhje me llojin e emergjencës.

5.5.5. Subjekti përshkruan se si janë alokuar burimet dhe mjetet për menaxhimin e emergjencave (shih 4.1, “Burimet”) dhe si janë identifikuar kërkesat për trajnim (shih 4.2, “Kompetenca”).

5.5.6. Marrëveshjet emergjente testohen rregullisht në bashkëpunim me palët e tjera të interesuara dhe përditësohen kur është e nevojshme.

5.5.7. Subjekti siguron që personeli kompetent përgjegjës, me aftësi të përshtatshme gjuhësore, të kontaktohet lehtësisht dhe pa vonesë nga administratori i infrastrukturës dhe i ofron këtij të fundit nivelin e duhur të informacionit.

5.5.8. Subjekti harton një procedurë për të kontaktuar subjektin përgjegjës për mirëmbajtjen



ose mbajtësin e mjeteve hekurudhore në rast emergjence.

6. Vlerësimi i performancës

6.1. Monitorimi

6.1.1. Subjekti kryen monitorimin në përputhje me urdhrin e MIE-s nr. 170, datë 13.12.2023, sa më sipër, dhe:

a) kontrollon zbatimin e saktë dhe efektivitetin e të gjitha proceseve dhe procedurave në sistemin e menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë masat e sigurisë operationale, organizative dhe teknike;

b) kontrollon zbatimin e saktë të sistemit të menaxhimit të sigurisë në tërësi dhe nëse ai arrin rezultatet e pritura;

c) heton nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

ç) identifikon, zbaton dhe vlerëson efektivitetin e masave korrigjuese (shih 7.2, “Përmirësimi i vazhdueshëm”), sipas rastit, nëse zbulohet ndonjë rast përkatës i mospërputhjes me shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij paragrafi.

6.1.2. Subjekti monitoron rregullisht në të gjitha nivelet brenda sipërmarrjes hekurudhore për kryerjen e detyrave të lidhura me sigurinë dhe ndërhyr nëse këto detyra nuk po kryhen siç duhet.

6.2. Auditimi i brendshëm

6.2.1. Subjekti kryen auditime të brendshme në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe transparente për të mbledhur dhe analizuar informacionin për qëllimet e aktiviteteve të saj monitoruese (shih 6.1, “Monitorimi”), duke përfshirë:

a) Një plan i auditimeve të brendshme të planifikuar, i cili mund të rishikohet në varësi të rezultateve të auditimeve të mëparshme dhe monitorimit të performancës;

b) identifikimi dhe përzgjedhja e auditorëve kompetentë (shih 4.2, “Kompetenca”);

c) analiza dhe vlerësimi i rezultateve të auditimeve;

ç) identifikimi i nevojës për masa korrigjuese ose përmirësuese;

d) verifikimin e përfundimit dhe efektivitetit të këtyre masave;

dh) dokumentacionin që ka të bëjë me ekzekutimin dhe rezultatet e auditimeve;

e) Komunikimi i rezultateve të auditimeve te drejtuesi i lartë.

6.3. Rishikimi i drejtuesit

6.3.1. Drejtuesi i lartë rishikon rregullisht përshtatshmërinë dhe efektivitetin e vazhdueshëm

të sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë të paktën konsiderimin e:

a) detajeve të progresit në adresimin e veprimeve të pazgjidhura nga rishikimet e mëparshme të drejtuesit;

b) ndryshimin e rrethanave të brendshme dhe të jashtme (shih 1, “Konteksti i sipërmarrjes hekurudhore”);

c) performancën e sigurisë së sipërmarrjes hekurudhore në lidhje me:

i. arritjen e objektivave të tij të sigurisë;

ii. rezultatet nga aktivitetet e tij monitoruese, duke përfshirë gjetjet e auditimit të brendshëm, dhe investigimet e brendshme të aksidenteve/incidenteve dhe statusin e veprimeve të tyre përkatëse;

iii. rezultatet përkatëse nga aktivitetet mbikëqyrëse të kryera nga ASH-ja;

ç) rekomandime për përmirësim.

6.3.2. Bazuar në rezultatet e rishikimit të tij të menaxhimit, drejtuesi i lartë merr përgjegjësinë e përgjithshme për planifikimin dhe për zbatimin e ndryshimeve të nevojshme në sistemin e menaxhimit të sigurisë.

7. Përmirësimi

7.1. Mësoni nga aksidentet dhe nga incidentet

7.1.1. Aksidentet dhe incidentet që lidhen me operationet hekurudhore të sipërmarrjes hekurudhore të jenë:

a) raportuar, regjistruar, investiguar dhe analizuar për të përcaktuar shkaqet e tyre;

b) raportuar tek organet kombëtare sipas rastit.

7.1.2. Subjekti të sigurojë që:

a) rekomandimet nga ASH-ja, autoriteti investigues dhe investigimet e industrisë/të brendshme vlerësohen dhe zbatohen nëse është e përshtatshme ose e mandatuar;

b) të konsiderohen raportet/informacionet përkatëse nga palë të tjera të interesuara si sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe mbajtësit e mjeteve hekurudhore.

7.1.3. Subjekti përdor informacionin në lidhje me investigimin për rishikimin e vlerësimit të rrezikut (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”), me synimin të përmirësojë sigurinë dhe, kur është e aplikueshme, të miratojë masa korrigjuese dhe/ose përmirësimi (shih 5.4, “Menaxhimi e ndryshimit”).



7.2. Përmirësim i vazhdueshëm

7.2.1. Subjekti përmirëson vazhdimisht përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të saj të menaxhimit të sigurisë, duke marrë parasysh kuadrin e përcaktuar në urdhrin e MIE-s nr. 170, datë 13.12.2023, dhe të paktën rezultatet e aktiviteteve të mëposhtme:

- a) monitorimi (shih 6.1, “Monitorimi”);
- b) auditimi i brendshëm (shih 6.2, “Auditimi i brendshëm”);
- c) rishikimi i drejtuesit (shih 6.3, “Rishikimi i drejtuesit”);

d) të mësuarit nga aksidentet dhe incidentet (shih 7.1, “Të mësuarit nga aksidentet dhe incidentet”).

7.2.2. Subjekti siguron mjete për motivimin e stafit dhe palëve të tjera të interesuara që të jenë aktive në përmirësimin e sigurisë si pjesë e mësimit të saj organizativ.

7.2.3. Subjekti siguron një strategji për përmirësimin vazhdimisht të kulturës së saj të sigurisë, duke u mbështetur në përdorimin e ekspertizës dhe metodave të njohura të identifikimit të çështjeve që prekin pjesë të ndryshme të sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe të vendosë masa për përmirësimin e tyre.

ANEKSI IV

KËRKESAT E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË SIGURISË NË LIDHJE ME ADMINISTRATORËT E INFRASTRUKTURËS

1. Konteksti i administratorit të infrastrukturës

1.1. Administratori i infrastrukturës, në vijim “shoqëria”:

a) përshkruan karakterin dhe shtrirjen e operacioneve të tij;

b) identifikon rreziqet serioze për sigurinë që paraqesin operacionet e saj hekurudhore nëse ato kryhen nga vetë ai, ose nga kontraktorët, partnerët ose furnizuesit nën kontrollin e tij;

c) identifikon palët e interesuara (p.sh., autoritetin rregullator dhe autoritetet e tjera hekurudhore, sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës, kontraktorët, furnizuesit, partnerët), duke përfshirë ato palë jashtë sistemit hekurudhor, që janë të rëndësishme për sistemin e menaxhimit të sigurisë;

ç) identifikon dhe mban kërkesat ligjore dhe të tjera në lidhje me sigurinë nga palët e interesuara të përmendura në pikën “c”;

d) siguron që kërkesat e përmendura në pikën “d” të merren parasysh në zhvillimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit të sigurisë;

dh) përshkruan objektin e sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke treguar se cila pjesë e biznesit është e përfshirë ose jo në objektin e tij dhe duke marrë parasysh kërkesat e përmendura në pikën “d”.

1.2. Për qëllime të këtij aneksi zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “karakter”, në lidhje me operacionet hekurudhore të kryera nga administratorët e infrastrukturës, nënkupton karakterizimin e operimit sipas fushëveprimit të tij, duke përfshirë projektimin dhe ndërtimin e infrastrukturës, mirëmbajtjen e infrastrukturës, planifikimin e trafikut, menaxhimin dhe kontrollin e trafikut, dhe nga përdorimi i infrastrukturës hekurudhore, duke përfshirë linja konvencionale dhe/ose me shpejtësi të lartë, transport udhëtarësh dhe/ose mallrash;

b) “shtrirja”, në lidhje me operacionet hekurudhore të kryera nga administratorët e infrastrukturës, nënkupton shtrirjen e karakterizuar nga gjatësia e gjurmës hekurudhore dhe madhësia e vlerësuar e administratorit të infrastrukturës për sa i përket numrit të punonjësve që punojnë në sektorin hekurudhor.

2. Drejtimi

2.1. Drejtuesi i lartë dhe përkushtimi

2.1.1. Drejtuesi i lartë demonstroi leadership dhe përkushtim për zhvillimin, për zbatimin, për mirëmbajtjen dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke:

a) marrë përgjegjësinë e përgjithshme për sigurinë;

b) siguruar përkushtim ndaj sigurisë në nivele të ndryshme brenda shoqërisë nëpërmjet aktiviteteve të tyre dhe në marrëdhëniet e tyre me stafin dhe kontraktorët;

c) siguruar që politika e sigurisë dhe objektivat e sigurisë janë krijuar, kuptuar dhe janë në përputhje me drejtimin strategjik të shoqërisë;

ç) siguruar integritet të kërkesave të sistemit të menaxhimit të sigurisë në proceset e biznesit të shoqërisë;

d) siguruar që burimet e nevojshme për sistemin e menaxhimit të sigurisë janë të disponueshme;



dh) siguruar që sistemi i menaxhimit të sigurisë të jetë efektiv në kontrollin e rreziqeve të sigurisë të paraqitura nga shoqëria;

e) inkurajuar stafin për të mbështetur pajtueshmërinë me kërkesat e sistemit të menaxhimit të sigurisë;

ë) promovuar përmirësim të vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë;

f) siguruar që siguria merret parasysh kur identifikohen dhe menaxhohen rreziqet e biznesit të shoqërisë dhe shpjegohet se si do të njihet dhe zgjidhet konflikti midis sigurisë dhe qëllimeve të tjera të biznesit;

g) promovuar një kulturë pozitive sigurie.

2.2. Politika e sigurisë

2.2.1. Një dokument që përshkruan politikën e sigurisë së shoqërisë është krijuar nga drejtuesi i lartë dhe është:

a) e përshtatshme për karakterin e shoqërisë dhe për shtrirjen e operacioneve hekurudhore;

b) miratuar nga drejtuesi ekzekutiv i shoqërisë (ose një përfaqësues/ët e drejtuesit të lartë);

c) zbatuar në mënyrë aktive, komunikuar dhe vënë në dispozicion të gjithë stafit.

2.2.2 Politika e sigurisë:

a) përfshin një angazhim për të përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe të tjera që lidhen me sigurinë;

b) siguron një kornizë për vendosjen e objektivave të sigurisë dhe vlerësimin e performancës së sigurisë së shoqërisë kundrejt këtyre objektivave;

c) përfshin një angazhim për të kontrolluar rreziqet e sigurisë që lindin si nga aktivitetet e tij ashtu edhe nga ato të shkaktuara nga të tjerët;

ç) përfshin një angazhim për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë;

d) mbahet në përputhje me strategjinë e biznesit dhe vlerësimin e performancës së sigurisë të shoqërisë.

2.3. Rolet organizative, përgjegjësitë, detyrat dhe autoritetet

2.3.1. Përgjegjësitë, detyrat dhe autoritetet e personelit që ka një rol që ndikon në sigurinë (përfshirë drejtuesin dhe stafin tjetër të përfshirë në detyrat e lidhura me sigurinë) përcaktohen në të gjitha nivelet brenda shoqërisë, dokumentohen, ndahen dhe u komunikohen personave përgjegjës.

2.3.2. Shoqëria siguron që personeli me përgjegjësi të deleguara për detyrat e lidhura me

sigurinë të ketë autoritetin, kompetencën dhe burimet e duhura për të kryer detyrat e tyre, pa u ndikuar negativisht nga aktivitetet e funksioneve të tjera të biznesit.

2.3.3 Delegimi i përgjegjësisë për detyrat e lidhura me sigurinë dokumentohet dhe i komunikohet personelit përkatës, i cili i kupton dhe i pranon.

2.3.4 Shoqëria përshkruan ndarjen e roleve të përmendura në paragrafin 2.3.1, për funksionet e biznesit brenda dhe aty ku është e rëndësishme, jashtë shoqërisë (shih 5.3, “Kontraktorët, partnerët dhe furnitorët”).

2.4. Konsultimi i stafit dhe i palëve të tjera

2.4.1. Stafi, përfaqësuesit e tyre dhe palët e jashtme të interesuara, sipas rastit dhe kur është e përshtatshme, konsultohen për zhvillimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë në pjesët përkatëse për të cilat ata janë përgjegjës, duke përfshirë aspektet e sigurisë të procedurave operacionale.

2.4.2. Shoqëria lehtëson konsultimin me personelin, duke ofruar metoda dhe mjete për përfshirjen e stafit, bën dokumentimin e opinionit të personelit dhe komente mbi atë opinion.

3. Planifikimi

3.1. Veprimet për të adresuar rreziqet

3.1.1. Vlerësimi i rrezikut

3.1.1.1. Shoqëria:

a) identifikon dhe analizon të gjitha rreziqet operacionale, organizative dhe teknike të lidhura me karakterin dhe shtrirjen e operacioneve të kryera. Rreziqe të tilla përfshijnë ato që rrjedhin nga faktorë njerëzorë dhe organizativë, si: ngarkesa e punës, dizajni i punës, lodhja ose përshtatshmëria e procedurave dhe aktivitetet e palëve të tjera të interesuara (shih 1, “Konteksti i shoqërisë”);

b) vlerëson rreziqet e përmendura në pikën “a”, duke aplikuar metodat e duhura të vlerësimit të rrezikut;

c) zhvillon dhe vendos masa sigurie, me identifikimin e përgjegjësive të ndërlidhura (shih 2.3, “Rolet organizative, përgjegjësitë, përgjegjësitë, detyrat dhe autoritetet”);

ç) zhvillon një sistem për monitorimin e efektivitetit të masave të sigurisë (shih 6.1, “Monitorimi”);

d) njeh nevojën për të bashkëpunuar me palët e tjera të interesuara (si sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës, prodhuesit, furnizuesit e mirëmbajtjes, subjektet përgjegjëse për



mirëmbajtjen, përdoruesit e mjeteve hekurudhore, ofrueset e shërbimeve dhe entin e prokurimit), sipas rastit, për rreziqet e përbashkëta dhe vënien në vend të masave adekuata të sigurisë;

dh) i komunikon rreziqet stafit dhe palëve të jashtme të përfshira (shih 4.4, “Informacioni dhe komunikimi”).

3.1.1.2. Gjatë vlerësimit të rrezikut, shoqëria merr parasysh nevojën për të përcaktuar, për të siguruar dhe për të mbajtur një mjedis të sigurt pune, që është në përputhje me legjislacionin në fuqi, në veçanti me ligjin nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.

3.1.2. Planifikimi për ndryshim

3.1.2.1 Shoqëria identifikon rreziqet e mundshme të sigurisë dhe masat e duhura të sigurisë (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”) përpara zbatimit të një ndryshimi (shih 5.4, “Menaxhimi i ndryshimit”) në përputhje me procesin e menaxhimit të rrezikut, duke përfshirë marrjen në konsideratë të rreziqeve të sigurisë nga vetë procesi i ndryshimit.

3.2. Objektivat dhe planifikimi i sigurisë

3.2.1. Shoqëria përcakton objektivat e sigurisë për funksionet përkatëse në nivelet përkatëse për të ruajtur dhe, kur është praktikisht e arsyeshme, për të përmirësuar performancën e saj të sigurisë.

3.2.2. Objektivat e sigurisë duhet:

a) të jenë në përputhje me politikën e sigurisë dhe objektivat strategjikë të shoqërisë (aty ku është e aplikueshme);

b) të jenë të lidhur me rreziqet prioritare, që ndikojnë në performancën e sigurisë së shoqërisë;

c) të jenë të matshëm;

ç) marrin parasysh kërkesat ligjore dhe të tjera në fuqi;

d) të rishikohen në lidhje me arritjet e tyre dhe të rishikohen sipas nevojës;

dh) të komunikohen.

3.2.3. Shoqëria të ketë plane për të përshkruar se si do të arrijë objektivat e saj të sigurisë.

3.2.4. Shoqëria përshkruan strategjinë dhe planin/et e përdorur/a për të monitoruar arritjen e objektivave të sigurisë (shih 6.1, “Monitorimi”).

4. Mbështetje

4.1. Burimet

4.1.1. Shoqëria siguron burimet, duke përfshirë stafin kompetent dhe pajisjet efektive dhe të përdorshme, të nevojshme për ngritjen, zbatimin,

mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë.

4.2. Kompetenca

4.2.1. Sistemi i menaxhimit të kompetencave të shoqërisë siguron që personeli që ka një rol, që ndikon në sigurinë është kompetent në detyrat e lidhura me sigurinë për të cilat ata janë përgjegjës (shih 2.3, “Rolet organizative, përgjegjësitë, detyrat dhe autoritetet”), duke përfshirë të paktën:

a) identifikimin e kompetencave (përfshirë njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe qëndrimet joteknike) të nevojshme për detyrat që lidhen me sigurinë;

b) parimet e përzgjedhjes (niveli bazë arsimor, aftësia psikologjike dhe fizike e nevojshme);

c) trajnimin fillestar, përvojën dhe kualifikimin;

ç) trajnimi i vazhdueshëm dhe përditësimi periodik i kompetencave ekzistuese;

d) vlerësimi periodik i kompetencës dhe kontrollet e aftësisë psikologjike dhe fizike për të siguruar që kualifikimet dhe aftësitë mbahen me kalimin e kohës;

dh) trajnime specifike në pjesët përkatëse të sistemit të menaxhimit të sigurisë në mënyrë që të kryejnë detyrat e tyre të lidhura me sigurinë.

4.2.2. Shoqëria siguron një program trajnimi, siç përmendet në pikat “c”, “ç” dhe “dh” të paragrafit 4.2.1, për personelin që kryen detyra të lidhura me sigurinë, i cili siguron që:

a) programi i trajnimit ofrohet sipas kërkesave të identifikuara të kompetencave dhe nevojave individuale të personelit;

b) aty ku është e aplikueshme, trajnimi siguron që stafi të operojë në të gjitha kushtet e funksionimit (normale, të degraduara dhe emergjente);

c) kohëzgjatja e trajnimit dhe frekuenca e trajnimit rifreskues janë të përshtatshme për objektivat e trajnimit;

ç) mbahen shënime për të gjithë stafin (shih 4.5.3, “Kontrolli i informacionit të dokumentuar”);

d) programi i trajnimit rishikohet dhe auditohet rregullisht (shih 6.2, “Auditimi i brendshëm”) dhe bëhen ndryshime kur është e nevojshme (shih 5.4, “Menaxhimi i ndryshimit”).

4.2.3. Për personelin pas aksidenteve/incidenteve ose mungesave të gjata nga puna duhet të ketë marrëveshje për kthimin e tyre në punë duke përfshirë ofrimin e trajnimeve shtesë kur identifikohet një nevojë e tillë.



4.3. Ndërgjegjësimi

4.3.1. Drejtuesi i lartë siguron që ata dhe stafi i tyre që ka një rol që ndikon në sigurinë janë të vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojat e aktiviteteve të tyre dhe se si ato kontribuojnë në zbatimin e saktë dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë arrijtjen e objektivave të sigurisë (shih 3.2, “Objektivat dhe planifikimi i sigurisë”).

4.4. Informacioni dhe komunikimi

4.4.1. Shoqëria përcakton kanalet e duhura të komunikimit për të siguruar që informacioni në lidhje me sigurinë të shkëmbehet ndërmjet niveleve të ndryshme të shoqërisë dhe me palët e jashtme të interesuara, duke përfshirë kontraktorët, partnerët dhe furnizuesit.

4.4.2. Për të siguruar që informacioni i lidhur me sigurinë të arrijë tek ata që marrin gjykime dhe vendime, shoqëria duhet të menaxhojë identifikimin, marrjen, përpunimin, gjenerimin dhe shpërndarjen e informacionit të lidhur me sigurinë.

4.4.3. Shoqëria siguron që informacioni i lidhur me sigurinë është:

- a) relevant, i plotë dhe i kuptueshëm për përdoruesit e synuar;
- b) i vlefshëm;
- c) i saktë;
- ç) konsistent;
- d) i kontrolluar (shih 4.5.3, “Kontrolli i informacionit të dokumentuar”);
- dh) i komunikuar përpara se të hyjë në fuqi;
- e) i marrë dhe i kuptuar.

4.5. Informacioni i dokumentuar

4.5.1. Dokumentacioni i sistemit të menaxhimit të sigurisë

4.5.1.1. Ekziston një përshkrim i sistemit të menaxhimit të sigurisë duke përfshirë:

- a) identifikimin dhe përshkrimin e proceseve dhe aktiviteteve që lidhen me sigurinë e operacioneve hekurudhore, duke përfshirë detyrat e lidhura me sigurinë dhe përgjegjësitë e ndërlidhura (shih 2.3, “Rolet organizative, përgjegjësitë, detyrat dhe autoritetet”);
- b) ndërveprimin e këtyre proceseve;
- c) procedurat ose dokumentet e tjera që përshkruajnë se si zbatohen këto procese;
- ç) identifikimin e kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve me një përshkrim të llojit dhe shtrirjes së shërbimeve të ofruara;
- d) identifikimin e marrëveshjeve kontraktuale dhe marrëveshjeve të tjera të biznesit, të lidhura

ndërmjet shoqërisë dhe palëve të tjera të identifikuara nën “ç”, të nevojshme për të kontrolluar rreziqet e sigurisë të shoqërisë dhe ato që lidhen me përdorimin e kontraktorëve;

dh) referencë për informacionin e dokumentuar të kërkuar nga kjo rregullore.

4.5.1.2. Shoqëria duhet të sigurojë që një raport vjetor i sigurisë t’i dorëzohet autoritetit (ose autoriteteve) përkatëse kombëtare të sigurisë, në përputhje me ligjet në fuqi, duke përfshirë:

a) një sintezë të vendimeve mbi nivelin e rëndësisë së ndryshimeve të lidhura me sigurinë, duke përfshirë një pasqyrë të ndryshimeve të rëndësishme, në përputhje me ligjet në fuqi;

b) objektivat e sigurisë të shoqërisë për vitin/et e ardhshëm/me dhe si ndikojnë rreziqet serioze për sigurinë në vendosjen e këtyre objektivave të sigurisë;

c) rezultatet e hetimit të brendshëm të aksidenteve/incidenteve (shih 7.1, “Mësimi nga aksidentet dhe incidentet”) dhe aktivitetet e tjera monitoruese (shih 6.1, “Monitorimi”, 6.2, “Auditimi i brendshëm”, dhe 6.3, “Rishikimi i drejtuesit”);

ç) detajet e progresit në adresimin e rekomandimeve të pazgjidhura nga organet kombëtare të hetimit (shih 7.1, “Mësimi nga aksidentet dhe incidentet”);

d) treguesit e sigurisë së shoqërisë të përcaktuara për të vlerësuar performancën e sigurisë së shoqërisë (shih 6.1, “Monitorimi”);

dh) sipas rastit, konkluzionet e raportit vjetor të këshilltarit të sigurisë, siç përmendet në RID mbi aktivitetet e shoqërisë në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme.

4.5.2. Krijimi dhe përditësimi

4.5.2.1. Shoqëria siguron që gjatë krijimit dhe përditësimit të informacionit të dokumentuar në lidhje me sistemin e menaxhimit të sigurisë të përdoren formatet dhe mediat adekuate.

4.5.3. Kontrolli i informacionit të dokumentuar

4.5.3.1. Shoqëria kontrollon informacionin e dokumentuar në lidhje me sistemin e menaxhimit të sigurisë, në veçanti ruajtjen, shpërndarjen dhe kontrollin e ndryshimeve, për të siguruar disponueshmërinë, përshtatshmërinë dhe mbrojtjen e tij aty ku është e nevojshme.



4.6. Integrimi i faktorëve njerëzorë dhe organizativë

4.6.1. Shoqëria demonstroi një qasje sistematike për integrimin e faktorëve njerëzorë dhe organizativë brenda sistemit të menaxhimit të sigurisë. Kjo qasje do të:

a) përfshijë zhvillimin e një strategjie dhe përdorimin e ekspertizës dhe metodave të njohura nga fusha e faktorëve njerëzorë dhe organizativë;

b) adresojë rreziqet që lidhen me projektimin dhe përdorimin e pajisjeve, detyrat, kushtet e punës dhe rregullimet organizative, duke marrë parasysh aftësitë njerëzore, si dhe kufizimet, dhe ndikimet në performancën njerëzore.

5. Zbatimi

5.1. Planifikimi dhe kontrolli operacional

5.1.1. Gjatë planifikimit, zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit të proceseve të saj operacionale, shoqëria siguron që gjatë operimit:

a) zbatohen kriteret e pranimi të rrezikut dhe masat e sigurisë (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”);

b) janë dorëzuar planet për të arritur objektivat e sigurisë (shih 3.2, Objektivat dhe planifikimi i sigurisë”);

c) informacioni mbledhet për të matur zbatimin e saktë dhe efektivitetin e aranzhimeve operacionale (shih 6.1, “Monitorimi”).

5.1.2. Shoqëria siguron që marrëveshjet e saj operacionale të jenë në përputhje me kërkesat e lidhura me sigurinë e specifikimeve teknike të zbatueshme për ndërveprueshmërinë dhe rregullat përkatëse kombëtare dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse.

5.1.3. Për të kontrolluar rreziqet aty ku është e rëndësishme për sigurinë e aktiviteteve operacionale (shih 3.1.1, “Vlerësimi i rrezikut”), duhet të merren parasysh të paktën sa vijon:

a) identifikimi i kufijve të sigurt të transportit për planifikimin dhe kontrollin e trafikut bazuar në karakteristikat e projektimit të infrastrukturës;

b) planifikimi i trafikut, duke përfshirë orarin dhe caktimin e shtegut të trenave;

c) menaxhimi i trafikut në kohë reale në gjendje normale dhe në mënyra të degraduara me aplikimin e kufizimeve të përdorimit të trafikut dhe menaxhimit të ndërprerjeve të trafikut;

ç) vendosja e kushteve për drejtimin e ngarkesave të jashtëzakonshme.

5.1.4. Për të kontrolluar shpërndarjen e përgjegjësi aty ku është e rëndësishme për sigurinë

e aktiviteteve operacionale, shoqëria identifikon përgjegjësitë për planifikimin dhe funksionimin e rrjetit hekurudhor dhe të përcaktojë se si detyrat përkatëse që ndikojnë në ofrimin e sigurt të të gjitha shërbimeve që i ndahen personelit kompetent brenda shoqërisë dhe palëve të tjera të kualifikuara kur është e përshtatshme.

5.1.5. Për të kontrolluar informacionin dhe komunikimin aty ku është e rëndësishme për sigurinë e aktiviteteve operacionale personeli përkatës (p.sh., sinjalizuesit) duhet të informohet për kërkesat specifike të linjës për trenat dhe lëvizjet e mjeteve, duke përfshirë ndryshimet përkatëse që mund të rezultojnë në rrezik, kufizime të përkohshme ose të përhershme operacionale (p.sh., për shkak të mirëmbajtjes së linjave) dhe kushte për dërgesa të jashtëzakonshme aty ku është e aplikueshme.

5.1.6. Për të kontrolluar kompetencën aty ku është e rëndësishme për sigurinë e aktiviteteve operacionale, shoqëria siguron, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për stafin e saj:

a) pajtueshmërinë me udhëzimet e tyre të trajnimit dhe të punës, dhe ndërmerren veprimet korrigjuese aty ku kërkohet;

b) trajnime specifike në rast të ndryshimeve të parashikuara që ndikojnë në drejtimin e operacioneve ose caktimin e detyrave të tyre;

c) miratimi i masave adekuate pas aksidenteve dhe incidenteve.

5.2. Menaxhimi i aseteve

5.2.1. Shoqëria menaxhon rreziqet e sigurisë që lidhen me asetet fizike gjatë gjithë ciklit të jetës të tyre, nga projektimi deri në asgjësimin e tyre, dhe përmbush kërkesat e faktorëve njerëzorë në të gjitha fazat e ciklit jetësor.

5.2.2. Shoqëria:

a) siguron që asetet të përdoren për qëllimin e synuar, duke ruajtur gjendjen e tyre të sigurt operacionale dhe nivelin e tyre të pritur të performancës;

b) menaxhon asetet në funksione normale dhe të degraduara;

c) zbulon sa më shpejt të jetë e mundur raste të mospërputhjes me kërkesat e funksionimit përpara ose gjatë funksionimit të aktivitetit, duke përfshirë zbatimin e kufizimeve të përdorimit sipas rastit për të siguruar një gjendje të sigurt funksionimi të aktivitetit.

5.2.3. Shoqëria siguron që masat e marra për menaxhimin e aseteve, aty ku është e aplikueshme,



të jenë në përputhje me të gjitha kërkesat thelbësore të përcaktuara në specifikimet teknike përkatëse për ndërveprueshmërinë dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse.

5.2.4. Për të kontrolluar rreziqet, kur është e rëndësishme për furnizimin e mirëmbajtjes, merren parasysh të paktën sa vijon:

a) identifikimin e nevojës për mirëmbajtje për të mbajtur infrastrukturën në një gjendje të sigurt funksionale, bazuar në përdorimin e planifikuar dhe real të infrastrukturës dhe karakteristikat e projektimit të saj;

b) menaxhimin e largimit të aktivitetit nga operimi për mirëmbajtje, kur janë identifikuar defekte ose kur gjendja e asetit degradon jashtë kufijve të një gjendjeje të sigurt operative, siç përmendet në pikën “a”;

c) menaxhimin e kthimit në funksionim të asetit me kufizime eventuale të përdorimit pas dorëzimit të mirëmbajtjes për të siguruar që ai është në një gjendje të sigurt funksionale;

ç) menaxhimin e pajisjeve të monitorimit dhe të matjes për të siguruar që ato janë të përshtatshme për qëllimin e synuar.

5.2.5. Për të kontrolluar informacionin dhe komunikimin aty ku është e rëndësishme për menaxhimin e sigurt të aseteve, shoqëria merr parasysh:

a) shkëmbimin e informacionit përkatës brenda shoqërisë ose me entitete të jashtme përgjegjëse për mirëmbajtjen, veçanërisht për keqfunksionimet, aksidentet, incidentet e lidhura me sigurinë si dhe për kufizimet eventuale të përdorimit të aktivitetit;

b) gjurmueshmërinë e të gjithë informacionit të nevojshëm, duke përfshirë informacionin në lidhje me pikën “a”;

c) krijimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave duke përfshirë menaxhimin e ndryshimeve që ndikojnë në sigurinë e aseteve.

5.3. Kontraktorët, partnerët dhe furnitorët

5.3.1. Shoqëria identifikon dhe kontrollon rreziqet e sigurisë që rrjedhin nga aktivitetet e jashtme, duke përfshirë operacionet ose bashkëpunimin me kontraktorët, partnerët dhe furnitorët.

5.3.2. Për të kontrolluar rreziqet e sigurisë të përmendura në paragrafin 5.3.1, shoqëria duhet të përcaktojë kriteret për përzgjedhjen e kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve dhe kërkesat e kontratës që ata duhet të përmbushin, duke përfshirë:

a) kërkesat ligjore dhe të tjera në lidhje me sigurinë;

b) nivelin e kompetencës që kërkohet për të kryer detyrat e përcaktuara në kontratë;

c) përgjegjësitë për detyrat që do të kryhen;

ç) performanca e pritshme e sigurisë që do të ruhet gjatë kontratës;

d) detyrimet në lidhje me shkëmbimin e informacionit të lidhur me sigurinë;

dh) gjurmueshmëria e dokumenteve të lidhura me sigurinë.

5.3.3. Shoqëria monitoron:

a) performancën e sigurisë së të gjitha aktiviteteve dhe operacioneve të kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve, për të siguruar që ata të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratë;

b) ndërgjegjësimin e kontraktorëve, partnerëve dhe furnitorëve për rreziqet e sigurisë që ato sjellin në operacionet e shoqërisë.

5.4. Menaxhimi i ndryshimit

5.4.1. Shoqëria zbaton dhe kontrollon ndryshimet në sistemin e menaxhimit të sigurisë për të ruajtur ose për të përmirësuar performancën e sigurisë. Kjo përfshin vendimet në fazat e ndryshme të menaxhimit të ndryshimit dhe rishikimin pasues të rreziqeve të sigurisë.

5.5. Menaxhimi i emergjencës

5.5.1. Shoqëria identifikon situatat emergjente dhe masat në kohë që duhen marrë për t'i menaxhuar ato dhe për të rivendosur kushtet normale të funksionimit.

5.5.2. Shoqëria sigurojë që, për çdo lloj emergjence të identifikuar:

a) shërbimet e urgjencës mund të kontaktohen menjëherë;

b) shërbimet e urgjencës u jepen të gjitha informacionet përkatëse si paraprakisht, për të përgatitur reagimin e tyre emergjent, ashtu edhe në momentin e një emergjence;

c) ndihma e parë ofrohet nga brenda.

5.5.3. Shoqëria identifikon dhe dokumenton rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve, në përputhje me ligjet në fuqi.

5.5.4. Shoqëria harton plane për veprim, alarme dhe informacione në rast emergjence, duke përfshirë veprimet:

a) të lajmërojë të gjithë stafin me përgjegjësi për menaxhimin e emergjencës;

b) t'u komunikojë informacion të gjitha palëve (p.sh., sipërmarrjet hekurudhore, kontraktorët,



autoritetet, shërbimet e urgjencës), duke përfshirë udhëzimet emergjente për udhëtarët;

c) të marrë çdo vendim të kërkuar në përputhje me llojin e emergjencës.

5.5.5. Shoqëria përshkruan se si janë alokuar burimet dhe mjetet për menaxhimin e emergjencave dhe si janë identifikuar kërkesat për trajnim.

5.5.6. Marrëveshjet emergjente testohen rregullisht në bashkëpunim me palët e tjera të interesuara dhe përditësohen kur është e nevojshme.

5.5.7. Shoqëria koordino planet e emergjencës me të gjitha sipërmarrjet hekurudhore që operojnë në infrastrukturën e shoqërisë, me shërbimet e emergjencës, në mënyrë që të lehtësojë ndërhyrjen e tyre të shpejtë dhe me çdo palë tjetër që mund të përfshihet në një situatë emergjente.

5.5.8. Shoqëria harton masa për të ndaluar operacionet dhe trafikun hekurudhor menjëherë, nëse është e nevojshme, dhe për të informuar të gjitha palët e interesuara për veprimet e ndërmarra.

5.5.9. Për infrastrukturën ndërkufitare, bashkëpunimi ndërmjet administratorëve përkatës të infrastrukturës lehtëson koordinimin dhe gatishmërinë e nevojshme të shërbimeve kompetente të urgjencës në të dyja anët e kufirit.

6. Vlerësimi i performancës

6.1. Monitorimi

6.1.1. Shoqëria për monitorimin:

a) të kontrollojë zbatimin e saktë dhe efektivitetin e të gjitha proceseve dhe procedurave në sistemin e menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë masat e sigurisë operacionale, organizative dhe teknike;

b) të kontrollojë zbatimin e saktë të sistemit të menaxhimit të sigurisë në tërësi dhe nëse ai arrin rezultatet e pritura;

c) të investigojë nëse sistemi i menaxhimit të sigurisë është në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;

ç) të identifikojë, zbatojë dhe vlerësojë efektivitetin e masave korrigjuese, sipas rastit, nëse zbulohet ndonjë rast përkatës i mospërputhjes me pikat “a”, “b” dhe “c”.

6.1.2. Shoqëria monitoron rregullisht në të gjitha nivelet brenda shoqërisë për kryerjen e detyrave të lidhura me sigurinë dhe ndërhyrjen nëse këto detyra nuk po kryhen siç duhet.

6.2. Auditimi i brendshëm

6.2.1. Shoqëria kryen auditime të brendshme në mënyrë të pavarur, të paanshme dhe transparente për të mbledhur dhe analizuar informacionin për

qëllimet e aktiviteteve të saj monitoruese, duke përfshirë:

a) një plan i auditimeve të brendshme të planifikuara, i cili mund të rishikohet në varësi të rezultateve të auditimeve të mëparshme dhe monitorimit të performancës;

b) identifikimi dhe përzgjedhja e auditorëve kompetentë;

c) analiza dhe vlerësimi i rezultateve të auditimeve;

ç) identifikimi i nevojës për masa korrigjuese ose përmirësuese;

d) verifikimin e përfundimit dhe efektivitetit të këtyre masave;

dh) dokumentacionin që ka të bëjë me ekzekutimin dhe rezultatet e auditimeve;

e) komunikimi i rezultateve të auditimeve të drejtuesit i lartë.

6.3. Rishikimi i drejtuesit

6.3.1. Drejtuesi i lartë rishikon rregullisht përshtatshmërinë dhe efektivitetin e vazhdueshëm të sistemit të menaxhimit të sigurisë, duke përfshirë të paktën konsiderimin e:

a) detajeve të progresit në adresimin e veprimeve të pazgjidhura nga rishikimet e mëparshme të drejtuesit;

b) ndryshimin e rrethanave të brendshme dhe të jashtme;

c) performancën e sigurisë të shoqërisë në lidhje me:

i. arritjen e objektivave të tij të sigurisë;

ii. rezultatet nga aktivitetet e tij monitoruese, duke përfshirë gjetjet e auditimit të brendshëm, dhe hetimet e brendshme të aksidenteve/incidenteve dhe statusin e veprimeve të tyre përkatëse;

iii. rezultatet përkatëse nga aktivitetet mbikëqyrëse të kryera nga autoriteti kombëtar i sigurisë;

d) rekomandime për përmirësim.

6.3.2. Bazuar në rezultatet e rishikimit të tij të menaxhimit, drejtuesi i lartë merr përgjegjësinë e përgjithshme për planifikimin dhe për zbatimin e ndryshimeve të nevojshme në sistemin e menaxhimit të sigurisë.

7. Përmirësime

7.1. Mësoni nga aksidentet dhe nga incidentet

7.1.1. Aksidentet dhe incidentet që lidhen me operacionet hekurudhore të shoqërisë do të jenë:



a) raportuar, regjistruar, hetuar dhe analizuar për të përcaktuar shkaqet e tyre;

b) raportuar tek organet kombëtare sipas rastit.

7.1.2. Shoqëria siguron që:

a) rekomandimet nga autoriteti kombëtar i sigurisë, organi kombëtar i investigimit dhe hetimet e industrisë/të brendshme vlerësohen dhe zbatohen nëse është e përshtatshme ose e mandatur;

b) merren parasysh dhe konsiderohen raportet/informacionet përkatëse nga palë të tjera të interesuara, si: sipërmarrjet hekurudhore, administratorët e infrastrukturës, subjektet përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përdoruesit e mjeteve hekurudhore.

7.1.3. Shoqëria përdor informacionin në lidhje me investigimin për të rishikuar vlerësimin e rrezikut, për të mësuar me synimin për të përmirësuar sigurinë dhe, kur është e aplikueshme, për të miratuar masa korrigjuese dhe/ose përmirësuese.

7.2. Përmirësim i vazhdueshëm

7.2.1. Shoqëria përmirëson vazhdimisht përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemit të saj të menaxhimit të sigurisë, duke marrë parasysh kuadrin ligjor dhe të paktën rezultatet e aktiviteteve të mëposhtme:

a) monitorimi;

b) auditimi i brendshëm;

c) rishikimi i drejtuesit;

ç) të mësuarit nga aksidentet dhe nga incidentet.

7.2.2. Shoqëria siguron mjete për motivimin e stafit dhe të palëve të tjera të interesuara që të jenë aktive në përmirësimin e sigurisë, si pjesë e mësimit të saj organizativ.

